# DËSHMI ARKIVI

**A-474741**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shtohen masat ndaj emigracionit, ministrat e Brendshëm të BE-së dhe Britanisë kërkojnë mekanizëm të ri për krizat dhe kthime të përshpejtuara |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/shtohen-masat-ndaj-emigracionit-ministrat-e-brendshem-te-be-se-dhe-britanis-i588825` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 19:53:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 20:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `76366ae3232fbfd601ad64c48e300daa71e2e255c2f0c294dda72d1cfd219a09` |
| TEKSTI | `dabda9fcb9e2b94c44eed3641dfa42adf9589d7b632cf27e7ad6c428e2497758` |
| PAMJA | `61a67097d207740e33b3ea0fa689850899a42b01226ec2d13ee9db32a284e961` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `509e1482eaeb302aa8da32177d58578d6c52122b64387712f7f971a233188992` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/509e1482eaeb302aa8da32177d58578d6c52122b64387712f7f971a233188992`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

Të fundit Gjermania: Vetoja për çështje dypalëshe të mos bllokojë BE-në Faik Islami, një jetë mes fjalës, vuajtjes dhe së vërtetës "Nuk kam gjetur personazh të tillë që..." - Ali Aliu rrë

# Shtohen masat ndaj emigracionit, ministrat e Brendshëm të BE-së dhe Britanisë kërkojnë mekanizëm të ri për krizat dhe kthime të përshpejtuara

TemA
27 Shtator 2026, 22:30Bota TEMA




Ministrat e brendshëm nga 17 vende të Bashkimit Evropian dhe Mbretëria e Bashkuar u mblodhën për të diskutuar forcimin e kontrolleve në kufijtë e jashtëm, shpejtimin e përgjigjes ndaj emergjencave migratore dhe zbatimin e procedurave të përshpejtuara për kthimin e personave pa të drejtë azili.

Takimi zhvillohet në një kohë kur blloku evropian po zbaton Paktin e ri për Migracionin dhe Azilin, të hyrë në fuqi në qershor, me qëllim unifikimin e rregullave dhe menaxhimin më efikas të kufijve komunitarë.

**Propozimi për një mekanizëm të ri emergjence**

Gjatë takimit, Ministri i Brendshëm gjerman, Alexander Dobrindt, theksoi nevojën për korniza të reja ligjore e teknike që t'u përgjigjen me shpejtësi situatave të krizës, duke përmendur si shembull presione të tilla si fluksi i fundit i kalimeve në enklavën spanjolle të Ceutës në kufi me Marokun.

*"Ekziston nevoja për një mekanizëm të ri evropian për krizën e migracionit. Ne duhet të kemi rregulla të qarta për identifikimin e emergjencave kufitare, një sistem operacional për t'iu përgjigjur atyre dhe procedura të përshpejtuara për kthimet.",* tha Alexander Dobrindt, ministër i Brendshëm i Gjermanisë.

Dobrindt shprehu gjithashtu shpresën se Agjencia Evropiane e Rojeve Kufitare dhe Bregdetare (Frontex) do të luajë një rol më aktiv dhe të drejtpërdrejtë në koordinimin e proceseve të dëbimit e kthimit të emigrantëve të paligjshëm.

**Rënia e kalimeve të paligjshme dhe qëndrimi i BE-së**

Nga ana e tij, Komisioneri i BE-së për Migracionin, Magnus Brunner, nëvizoi se masat e marra po japin rezultate konkrete në terren, ndonëse mbrojtja e kufijve mbetet përparësi absolute.

Sipas të dhënave zyrtare të paraqitura nga Komisioni, kërkesat për azil dhe tentativat për kalimin e Mesdheut kanë shënuar rënie të ndjeshme, ndonëse

rreziqet për udhëtarët mbeten të larta.

*“Migrimi i paligjshëm ka rënë ndjeshëm. Në dy vitet e fundit ai ka rënë me 55%, ndërsa vitin e kaluar ra përsëri me një të tretën. Ne si evropianë duam të vendosim se kush mund të qëndrojë në Evropë, dhe ata që nuk mund të qëndrojnë duhet të largohen. Për këtë bëhet fjalë.”*, theksoi Magnus Brunner, Komisioner i BE-së për Migracionin.

Takimi i nivelit të lartë rikonfirmoi orientimin e përbashkët të vendeve evropiane drejt një politike më strikte kufitare dhe rritjes së bashkëpunimit me Britaninë e Madhe në përballje me rrjetet e trafikimit të qenieve njerëzore.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Pas takimit Trump-Xi, dy pandat gjigante mbërrijnë nga Kina në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

21:30 Bota

Incident i ri sigurie/ OpenAI nën hetim për agjentët e Inteligjencës Artificiale, anashkaluan filtrat e faqes së OKB-së

21:00 Bota / 1 koment

[Referendumi për neutralitetin në Zvicër, qytetarët rrëzojnë propozimet për rregulla më të rrepta]

20:50 Bota

Skenar lufte/ Lituania teston evakuimin e Vilniusit në rast sulmi, stërvitja më e madhe ushtarake përfshin mijëra zyrtarë

20:00 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.